

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Modernizim i networkut ATS të transmetimit të të dhënave”,
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (F.P.P.):** Rrjete 32400000-7 ; Rrjet i komunikimeve 32412000-4; Ruter të rrjetit - 32413100-2
- **Vlera e fondit limit:** 15 980 000 *(pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 2. “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit

nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a.Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

b.Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e

nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë’
- **ISO 27001:2022**, “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit”
- **ISO 20000-1:2018**, “Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve IT”

ose versionet e përditësuara, lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim ose ekuivalente me to.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se ALBCONTROL sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë kompatibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtarë të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. ALBCONTROL është gjithashtu i çertifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Në kuadër të projektit të këtij projekti, kërkesa për çertifikimet ISO 9001:2015, ISO 27001:2022 dhe ISO 20000-1:2018 është thelbësore për të garantuar një proces të integruar, cilësor dhe të sigurt.

Standardi ISO 9001:2015 siguron që operatori ekonomik operon mbi baza të dokumentuara dhe të kontrolluara përmes një Sistemi Menaxhimi të Cilësisë, duke garantuar që instalimi, konfigurimi dhe testimi i pajisjeve kryhen sipas praktikave më të mira dhe me cilësi të lartë. Kjo ndihmon në minimizimin e gabimeve teknike dhe mospërputhjeve gjatë implementimit.

Standardi ISO 27001:2022 garanton që menaxhimi i informacionit sensitiv dhe i aksesit në sistemet e rrjetit bëhet në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar, duke reduktuar rreziqet e aksesit të paautorizuar dhe komprometimit të të dhënave.

Standardi ISO 20000-1:2018 siguron një qasje sistematike në menaxhimin e shërbimeve IT pas implementimit, duke mbështetur operimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe trajtimin efikas të incidenteve për funksionimin optimal dhe të qëndrueshëm të pajisjeve.

Këto çertifikime përbëjnë garanci të forta që procesi i dorëzimit, konfigurimit dhe operimit do të realizohet me standarde ndërkombëtare, duke siguruar cilësi, siguri dhe besueshmëri të lartë për të gjithë aktorët e përfshirë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për furnizimin e produkteve switche dhe firewall që ofertohen. Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë: emër prodhuesi dhe të dhëna mbi kompaninë. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori, duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (si kontratë, , deklaratë etj).

Argumentim: *Kërkesa për paraqitjen e Autorizimit nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet harduere që kerkohen të ofertohen, garanton se Operatori Ekonomik është në gjendje të ofrojë produktet drejtpërdrejt nga prodhuesi, sipas specifikimeve teknike të kerkuara për këtë procedure prokurimi.*

2.3.4 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij specialiste, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- 1) Te paktën 1 (një) udhëheqës projekti të diplomuar në shkenca kompjuterike apo elektronike. Udhëheqësi i projektit duhet të dëshmojë se ka aftësitë e duhura me anë të çertifikimit PMP ose të tjera ekuivalente, të njohura zyrtarisht për këtë qëllim.

Argumentimi: *Çertifikimi i mësipërm kerkohet për të siguruar menaxhim profesional dhe të strukturuar të projektit, duke garantuar koordinim efektiv, kontroll të rreziqeve dhe dorëzim cilësor brenda kohës dhe buxhetit të përcaktuar. Çertifikimi dëshmon aftësi të njohura ndërkombëtare për planifikim, monitorim dhe komunikim në projekte teknike kritike si ky.*

- 2) Të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar për ITIL ose ekuivalent me qëllim menaxhimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve të sigurisë, objekt të këtij prokurimi.

Argumentimi: *Për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës nga aspekti i menaxhimit të ofrimit me cilësi të shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve të sigurisë, objekt të këtij projekti, kerkohet një person me çertifikim ITIL për të siguruar menaxhimin profesional të shërbimeve IT pas përfundimit të implementimit të rrjetit, duke garantuar mirëmbajtje efektive, trajtim të shpejtë të incidenteve dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës së sistemit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Çertifikimi ITIL siguron njohuri të standardizuara për menaxhimin e shërbimeve dhe mbështetje të qëndrueshme të rrjetit të transmetimit të të dhënave.*

- 3) Të paktën 2 (dy) persona staf teknik të çertifikuar, minimalisht në nivel profesional për sigurinë e rrjetit kompjuterik, të leshuar nga prodhuesi i pajisjeve firewall ose nga autoritete të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi.

Argumentim: *Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë teknikë të çertifikuar, minimalisht në nivel profesional për sigurinë e rrjetit kompjuterik, të çertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve firewall ose nga autoritete çertifikuese të njohura prej tij, është vendosur me qëllim garantimin e kapaciteteve të nevojshme teknike për implementimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë së rrjetit,*

sipas standardeve të pranuara ndërkombëtarisht. Përcaktimi i minimumit prej dy specialistësh siguron mbulim të vazhdueshëm operacional, ndarje të ngarkesës së punës, reduktim të varësisë nga një individ i vetëm dhe rritje të qëndrueshmërisë në trajtimin e situatave të papritura apo kritike gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit.

- 4) Te pakten 2 (dy) specialiste për konceptet e routing dhe switching, të nivelit profesional ose më të avancuar, të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të rrjetit të ofertuara ose autoritete certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht.

Argumentim: Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në konceptet e routing dhe switching, në nivel profesional ose më të avancuar, nga prodhuesi i pajisjeve të rrjetit të ofruara ose autoritete certifikuese të njohura zyrtarisht, synon të sigurojë kapacitete teknike të mjaftueshme për konfigurimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit. Prania e dy specialistëve garanton mbulim të vazhdueshëm operacional dhe ndarje efektive të përgjegjësisë, duke minimizuar rreziqet e ndërprerjeve dhe vonesave gjatë realizimit dhe funksionimit të projektit.

Shënim:

Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikatë.

Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me:

- Certifikatat ose transkriptet përkatëse nga prodhuesit e teknologjive.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo më pak se 3 (tre) muaj, e vërtetuar kjo me formularin E-sig të listepagesave të deklaruara dhe të firmosura nga inspektorët tatimore.

Para dhënies së kontratës, për të dëshmuar disponimin e tyre, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet përkatëse ose transkripteve (në rastin kur aplikohet) të lëshuara nga prodhuesi. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë disponueshmërinë e secilit specialist për të angazhuar gjatë gjithë afatit të kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës (sipas pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar). Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues ALBCONTROL SH.A. në përputhje me nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*” të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të A.P.P. dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT